

VENDIM
Nr. 115, datë 27.2.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 206, DATË 7.4.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E STRUKTURAVE DHE
AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN INDIREKT DHE
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË
MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE TË
MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EVROPIAN, NË
KUADËR TË PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN RURAL TË INSTRUMENTIT PËR
ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT (IPARD III)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 11 e 12, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 206, datë 7.4.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe ushtrimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III)”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Struktura menaxhuese, e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA së, për zbatimin e programit IPARD III, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualët e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të ministrisë përgjegjëse për financat.”.

b) Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për financat ...”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama